REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 77/17
Datë/Datum. 16.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **21700/16/072/115**

Sa i përket tenderit për **Sistemi i menaxhimit të Informacionit për nevojat e FSK–së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Geo&Land sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Muharrem Fejza C15/11 Nr.7
(Adresa)

Prishtine — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+37744224853 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Ymer Kuka
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@geoland-kosova.com
(Adresa elektronike)

16.03.2017 — _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

Geo&Land sh.p.k Muharrem Fejza 10000, Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- ✓ ***Data e dorëzimit të ofertës 21.11.2016 ora 14.00***
- ✓ ***Hapja e ofertave: Nuk ka***
- ✓ ***Kriteri për dhënien e kontratës: Çmimi më i ulët***

- ✓ ***Vendimi i OSHP-së nr 465/16 i datës 09.02.2017***
- ✓ ***Njoftimi për anulimin e AP me datë 01.03.2017***
- ✓ ***Dorëzimi i kërkesës për rishqyrtim pranë AK me datë 03.03.2017***
- ✓ ***Vendimi i AK në lidhje me kërkesën për rishqyrtim me datë 08.03.2017***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Nuk kemi marë pjesë pasi nuk është organizuar fare procesi i hapjes së tenderëve me OE.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [x] Jo [ ]

Ne kemi pranuar njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit.
Brenda afatit ligjor kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim nga AK.
AK e ka cilësuar si të pa bazë kërkesën tonë.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e pretenduara sipas LPP *Ligji Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)*

1. *Neni 7*
2. *Neni 10 Pika 3, 4 dhe 5*
3. *Neni 59 Pika 2 dhe 4*
4. *Neni 62 Pika 1.1 dhe 2.2*
5. *Neni 65*
6. *Neni 105*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Procedura e ofertimit

Ne mendojmë qe AK ka zbatuar ne mënyrë korrekte dhe shume te sakte aktivitetin fillestar për projektin e lartcekur. Vendosja e kritereve ka qene ne përputhje te plote me LPP. Ndërsa specifikimet teknike kane qene shume detale dhe ne nuk kemi hasur ne specifika me profesionale deri me tani. Gjithashtu gjate procesit para hapjes se ofertave ne si OE kemi marre sqarimet e kërkuara dhe nuk kemi ankesë në to.

AK, ka shpërndarë dosjen dhe specifikat e projektit ne gjuhen shqipe, ndërsa me kërkesën tone gojore na është ofruar edhe specifika ne gjuhen angleze. Arsyen e kërkimit te specifikave ne gjuhen angleze e kemi bere ne mënyrë qe gjuha angleze ne shume raste është me e kuptueshme për çështje te IT. Ne kemi hasur ne një përkthim shume te mire te specifikave sepse na është thëne qe specifikat fillimisht janë realizuar ne gjuhen angleze, gjë që është normale për fushën e TI. Ne, gjatë përgatitjes së ofertës e kemi analizuar çdo

detal në gjuhen shqipe dhe angleze dhe nuk kemi lënë pa përfshirë asnjë detal sipas kërkesës së AK.

2. Procedura e vlerësimit

Edhe përkundër vendimit të OSHP-së nr. 465/16, datë 09.02.2017, ku kërkohet që procedura e prokurimit e cila është anuluar paraprakisht sipas vendimit te AK date 06.12.2016, të kthehet ne ri-vlerësim, AK nuk e ka përfillur fare këtë vendim, dhe ka marrë vendim për anulimin e tij pa i vlerësuar fare ofertat e OE. Këtë e konsiderojmë si shkelje të rëndë të LPP.

Zakonisht dhe siç parashihet me udhëzimet nga LPP, specifikat teknike përgatiten nga profesionistët dhe se pas publikimit të pyetjeve/sqarimeve në mes të OE dhe AK ky specifikacion konsiderohet i rregullt. Tendenca kryesore në këtë rast është që komisioni vlerësues, në vend që ti vlerësojë ofertat ai e ka vlerësuar specifikacionin teknik dhe e ka vënë në dyshim kompetencën profesionale të hartuesve të specifikacioneve teknike, gjë që është e pakuptimtë sepse komisioni vlerësues nuk mund të jetë me profesional se sa komisioni hartues. Gjithashtu, sipas këtyre arsyetimeve, që sipas mendimit tonë nuk ekzistojnë dhe nuk kanë asnjë bazë ligjore, AK rrjedhimisht po i vë para përgjegjësive ligjore të gjithë hartuesit e specifikacioneve teknike.

3. Sqarim mbi ankesën dhe vendimin paraprak në OSHP

Duke qenë se ne nuk ishim pajtuar me refuzimin e ankesës nga ana e AK të datës 13.12.2016, ne kemi parashtruar ankesë në OSHP me datë 20.12.2016. Si përfundim OSHP përmes vendimit nr 465/16 të datës 09.02.2017 ka aprovuar kërkesën tonë si të bazuar dhe ka paraqitur shkeljen nga ana e AK të LPP neni 62.2.2. Gjithashtu bazuar në LPP, AK është i obliguar që të respektojë vendimin e OSHP, gjë që nuk e ka bërë sipas vendimin të datës 01.03.2017 mbi anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit, tashmë për herën e dytë me radhë.

4. Shkeljet ligjore nga AK

Duke marrë parasysh natyrën e projektit me procedurë të kufizuar dhe negocim, ne pretendojmë shkelje ligjore mos vlerësimin e ofertave veç e veç nga ana AK, ashtu siç parashihet në LPP. Me këtë rast ne pretendojmë për diskriminim në momentin që është bërë verifikimi i çmimeve, ku ne si OE jemi më të favorshmit (Çmimi më i ulët) dhe në të njëjtën kohë AK nuk ka proceduar me vlerësim të ofertave.

Anulimin i këtij aktivitetit të prokurimit në këtë mënyrë, pa i vlerësuar fare OE e konsiderojmë si diskriminues dhe jo transparent dhe ne kundërshtim me nenet e lartcekura të LPP.

Arsyeshmëria e anulimit nuk koincidon me asnjë nen të LPP dhe si rrjedhojë ky anulim nuk ka bazë ligjore por është vetëm vlerësim subjektiv i njëanshëm dhe duke mos marrë parasysh vendimin e OSHP-se nr 465/16 për ri-vlerësim. Në vazhdim janë paraqitur arsyetimet e AK në vendimin e anulimit, dhe shpjegimi jonë pse arsyetimet e tilla nuk kanë asnjë baze ligjore.

4.1 PIKA 1: *"Ekziston një mospërputhje ndërmjeti kërkesave të përcaktuara ne Fletën e Dosjen e Tenderit(FTD) dhe Projektit (pika 7.2.1 Kërkesat për Kontraktorin-OE dhe produktet qe ofron, në lidhje me kërkesat të cilat duhet ti plotësoj Operatore Ekonomik".*

SQARIM: Ky arsyetim nuk ka asnjë bazë ligjore. Bazuar në LPP shumë qartë është e definuar se të gjitha kërkesat në lidhje me shërbimin apo produktin që kërkohen paraqiten ne kuadër te specifikimeve teknike, ku me këtë rast AK ka paraqitur këto në mënyrë shumë profesionale. **Ndërsa të gjitha kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale paraqiten në kuadër të Seksionin II të dosjes së tenderit, FDT neni 9.1 dhe 9.2**, të cilat po ashtu janë paraqitur në dosjen e tenderit. Si rrjedhojë, në dokumentacionin e këtij AP nuk ka asnjë mospërputhje të kërkesave ashtu siç është paraqitur si arsyetim në vendimin e anulimit. Edhe sikur të kishte, në Seksionin II të dosjes se tenderit thuhet se: **"Kurdo që paraqitet ndonjë mospërputhje, këto dispozita do të mbizotërojnë mbi ato në Informata për Tenderuesit". Përveç tjerash, ky arsyetim i cili ka qenë i njëjtë me arsyetimin e herës parë të anulimit datë 06.12.2016, është hedhur poshtë si plotësisht i pabazë në vendimin e OSHP-së nr 465/16, datë 09.02.2017.**

4.2 **PIKA 2:** *"Projekti i SMI-së duhet të jetë dokument i klasifikuar, ngase ne fazën e implementimit dhe integrimit të të dhënave behet i ndjeshëm bazuar në ligjin për klasifikimin e dokumentacionit në RKS neni 4 pika 1.3.2. mbrojtje, plane ushtarake, sisteme armësh, apo operacione dhe pika 1.3.5. sisteme, instalime, infrastruktura, projekte, plane apo shërbime të mbrojtjes që lidhen me interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës".*

SQARIM: Nuk është e qartë se pse AK bën ndërlidhje me një ligj që fare nuk ka të bëjë me implementimin e projektit në fjalë dhe gjithashtu keqinterpreton përmbajtjen e tij. Gjithashtu, duke u ndërlidhur me këtë ligj, AK keqinterpreton edhe përmbajtjen dhe qëllimin e projektit për të cilin po zhvillohet ky AP. Përveç që nuk është ligjore, nuk është as logjike të thuhet se projekti për zhvillimin e SMI të jetë dokument i klasifikuar. **Nuk ekziston asnjë ligj në Republikën e Kosovës që e lejon definimin e një projekti të tërë si një dokument të klasifikuar.** Pse ky arsyetim totalisht i pa qenë? Nëse ndërlidhja me këtë ligj bëhet në mungesë të njohurive, atëherë po sqarojmë se: Qëllimi i projektit SMI është zhvillimi i një sistemi kompjuterik/elektronik/digjital. Nëse ekziston një qëllim i tillë, kjo aspak nuk nënkupton që kompania që merret me zhvillimin e tij, duhet domosdoshmërish të ketë qasje në dokumentet zyrtare që më vonë mund të menaxhohen nga sistemi i krijuar. **Për më tepër, kjo qartësisht është e paraqitur edhe në kuadër të specifikimeve teknike të projektit.** Është më se e qartë se LIGJI Nr. 03/L-178 PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONEVE DHE VERIFIKIMIN E SIGURISË ka të bëjë decidivisht me klasifikimin dhe ruajtjen e informacioneve në kuadër të dokumenteve specifike. **Ndërsa, sa i përket sigurisë së sistemit (softuerit kompjuterik), AK në mënyrë shumë profesionale dhe ligjore ka paraqitur kërkesat e tilla në kuadër të pikës 5.2.3 dhe 5.2.4. Ne jemi pajtuar plotësisht me këto kërkesa.**

4.3 **PIKA 3:** *"Kompania përzgjedhëse e projektit SMI duhet të jete e verifikuar dhe e pajisur me certifikatë të sigurisë bazuar në nenin 45 dhe 46 të po të njëjtit Ligj. (pika 1 dhe 2) Pronarët, menaxhuesit dhe punonjësit e shoqërive tregtare dhe nën-kontraktuesit e tyre, të cilët janë të ftuar për të bërë ofertë, për të negociuar apo përmbushur një kontratë të klasifikuar apo që në një formë tjetër mund të ju jepet*

qasje në informacione të klasifikuara, kanë qasje në informacione të tilla të klasifikuara me kusht që të kenë leje të vlefshme të sigurisë të lëshuar nga Autoriteti Verifikues dhe që të kenë nevojë që të jenë në dijeni për këto informacione. Informacioni i klasifikuar i jepet një shoqërie tregtare vetëm me pëlqimin e institucionit publik nga i cili e ka origjinën ky informacion".

SQARIM: Fatkeqësisht, AK sërish ka vazhduar me keqinterpretimin e përmbajtjes se LIGJIT Nr. 03/L-178 PËR KLASIFIKIMIN E INFORMACIONEVE DHE VERIFIKIMIN E SIGURISË si dhe keqinterpretimin e përmbajtës dhe qëllimit të këtij AP. Edhe në këtë pikë duhet të theksojmë se ky projekt ka të bëjë me zhvillimin e një sistemi kompjuterik, qe aspak nuk nënkupton edhe qasjen ne informacionet që në të ardhmen mund të menaxhohen nga një sistem i tillë. Nuk ka mekanizëm i cili mund ta definoje një kompani qe i plotëson kërkesat e sigurisë sepse këto kërkesa mund të bëhen vetëm nga AK i cili mund të kërkojë nga organet kompetente përshtatshmërinë e sigurisë në rast se ajo është e kontraktuar. Me këtë rast AK prejudikon dhe në të njëjtën kohë diskriminon kompanitë ofertuese. **Për më tepër, paraqitja e një arsyetimi të tillë për anulim të këtij AP, paraqet shkelje të LPP, neni 65, i cili specifikon qartësisht kërkesat për përshtatshmërinë e ofertuesve.**

4.4 **PIKA 4:** *"Neni 46 i po të njëjtit Ligj (Pika 1 dhe 2). Shoqëritë tregtare dhe nën-kontraktuesit e tyre, pronarëve, menaxhuesve apo punonjësve të të cilëve u është dhënë në mënyrë të ligjshme qasje në informacione të klasifikuara garantojnë që objektet e tyre afariste, ku përdoren informacionet e tilla, i përmbushin standardet e sigurisë siç është përcaktuar me këtë ligj dhe me aktet nënligjore. Autoriteti Verifikues i inspekton objektet e tilla dhe e ndalon qasjen në informacione të klasifikuara nëse objektet afariste nuk i përmbushin standardet e sigurisë të përcaktuara në këtë ligj dhe me aktet nënligjore përkatëse. Autoriteti Verifikues, kohë pas kohe dhe pa njoftim paraprak inspekton objektet e shoqërive tregtare të cilat kanë qasje në informacione të klasifikuara".*

SQARIM: Lidhshmëria e nenit 46 të ligjit në fjalë, si arsyetim për të anuluar këtë procedure te prokurimit, përveç që është antiligjor dhe i palogjikshëm, njëkohësisht është edhe qesharak. **Nuk ekziston asnjë lidhshmëri e këtij neni të ligjit nr. 03/L-178 me projektin për të cilin zhvillohet ky AP.**

4.5 **PIKA 5:** *"Projekti i SMI-së duhet të rishikohet në tërësi ngase finalizimi i tij ka ndodhur para se të finalizohet Plani Afatgjatë Zhvillimor, Strategjia për Mbrojtje Kibernetike dhe Plani i Transformimit të MFSK-së dhe FSK-së. Në këtë drejtim:*

- *Numri i shfrytëzuesve i kërkuar me projekt dhe specifikacione teknike është shumë i vogël dhe nuk është në harmoni me strukturën e re.*
- *Kërkesat e organizatës për menaxhimin e pajisjeve dhe armatimit nuk është në harmoni me sistemin e FOCIS (Sistemi Informatik i Forcës i orientuar në Kosto) dhe me TOE (tabelën organizative të pajisjeve)*
- *Sistemi nuk përkrah strukturën sipas rekomandimeve të RSSS-së*

- *Projekti i SMI-së duhet të rishikohet ngase ekziston një dis-harmoni ne mes të versionit shqip dhe versionit anglisht, në versionin shqip shpesh eshtër përdoruar një terminologji teknologjike e pakuptueshme".*

SQARIM: Arsyetimet në këtë pikë janë në kundërshtim të plotë me LPP, gjithashtu vendimin e OSHP-së nr. 465/16, datë 09.02.2017. Përveç tjerash, arsyetimet në këtë pikë janë krejtësisht subjektive, paragjykuese dhe jo të saka, sepse oferta jonë për implementimin e sistemit në fjalë nuk ofron aspak kufizime në çështjet e cekura në këtë pikë. **Gjithashtu, sa i përket arsyetimit nga paragrafi i fundit në pikën 5, kjo qartësisht është hedhur poshtë nga vendimi i OSHP-së nr 465/16, ku ka paraqitur shkeljen e nenit 62.2.2 nga LPP.** Pra, oferta jonë nuk përmban kufizime të tilla, por për fat të keq AK nuk ka qenë i interesuar ti vlerësoj ato. Gjithashtu me procedurë të negociuar sipas dosjes së tenderit me këtë procedurë parashihet harmonizimi i të gjitha kërkesave në mes të AK dhe OE.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Përgatitja e ofertës ka koston 18% të vlerës së ofertës dhe kjo është vlera fillestare që kompania jonë dëmtohet në këtë rast.

Ne mendojmë se dëmi i përgjithshëm i shkaktuar kompanisë tonë është rreth 180mije euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
e) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*